

VENDIM
Nr. 228, datë 20.3.2013

**PËR NJË SHITESË FONDI NË BUXHETIN E VITIT 2013, MIRATUAR PËR MINISTRINË E
BRENDSHME, PËR MBULIMIN E SHPENZIMEVE TË KURIMIT TË SHTETASIT SHERIF
LAMI**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5 e 45 të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” dhe të nenit 13 të ligjit nr. 119/2012 “Për buxhetin e vitit 2013”, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ministrisë së Brendshme, në buxhetin e miratuar për vitin 2013, zëri “Shpenzime operative”, t’i shtohet fondi prej 832 000 (tetëqind e tridhjetë e dy mijë) lekësh, për mbulimin e shpenzimeve të kurimit të punonjësit të policisë, z. Sherif Maliq Lami.

2. Ky fond të përballohet nga fondi rezervë i Buxhetit të Shtetit.

3. Pagesa të bëhet kundrejt paraqitjes së faturave origjinale të institucionit shëndetësor të kurimit.

4. Ngarkohen Ministria e Brendshme dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha